



Primar / Doretuar Prilaps / Prilaps Received / Delivery	20.02.23	viti god year	
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKM/SJK	1925/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.17/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.17/2023 të datës 05.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa numër A.nr.17/2023 e datës 05.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

II.ANULOHET Vendimi i datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit.

III.Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën Udhëheqës i sektorit për inspektime/Drejtoria për Inspektime sipas akt emërimit të datës 01.07.2020 në Komunën e Gjilanit, më datë 05.01.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datën 05.01.2023 nën shenjë A.nr.17/2023 me numër protokoll 44/2023, kundër Vendimit të datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.01.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit. Ndërsa Këshilli më datë 30.01.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga organi i punësimit me numër protokoll 1084/2023 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 44/2023 të datës 05.01.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 16.01.2023 me numër protokoll 368/2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.01.2023 nga organi i punësimit me numër protokoll 1084/2023; Akt emërimi i datës 01.07.2020; Kërkesë për transferim të përkohshëm me nr.503 e datës 03.06.2022; Vendimi me nr.02-16-63238 i datës 03.06.2022; Kërkesa e datës 09.11.2022 me nr.ref.14-580/02-0131262/22-78 për iniciimin e procedurës disiplinore nga Drejtori i Drejtorisë të Inspektionit; Njoftim i datës 15.11.2022 me nr.02/016-133077; Ftesë për shqyrtim kryesor i datës 16.11.2022; Ftesë për shqyrtim kryesor e datës 22.11.2022 me nr.02-016-135394; Ftesë për shqyrtim kryesor e datës 05.12.2022; Njoftim i datës 21.11.2022 përmes e-mailit zyrtar; Njoftim i datës 07.12.2022; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 22.11.2022; Vazhdimi i seancës disiplinore e shtyrë me datë 08.12.2022; Procesverbal mbi konsultim dhe votim i datës 08.12.2022; Vendimi i datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Vendimi për shqiptimin e e masës disiplinore i datës 28.01.2022 me nr.56; Ankesë e datës 12.12.2022 për kryesuesin e Komisionit Disiplinor dhe Foto e datës 07.11.2022 e orës 8:16, E-mailat e datës 16.02.2023 të dërguar nga organi i punësimit dhe ankuesi, si dhe vendimi nr.02-1192, datë 11.11.2022 për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit A.K.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e **bazuar, SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi i datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 i

Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Legjislacionit që rregullon çështjen e Zyrtarëve Publik, çështjen e procedurës disiplinore dhe se me të njëjtin vendim të atakuar është konstatuar gabimishtë gjendja faktike.

Bazuar në shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi sipas kërkesës të datës 03.06.2022 me nr.pro.02-503 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit i cili kërkon që nëpunësi civil S.K, në këtë rast ankuesi në pozitë të rregullt të Udhëheqësit të Sektorit për Inspektime/Drejtoria për Inspektime sipas aktemërimit aktual të datës 01.07.2020 i cili ishte sistemuar përkohësisht në pozitë të Udhëheqësit të sektorit të financave në kuadër të Drejtorisë së Arsimit ,për interes të institucionit të transferohet përkohësisht në pozitën punuese Udhëheqës i sektorit për regjistrimin e bizneseve në kuadër të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, ndërsa sipas vendimit të datës 03.06.2022 me nr.02-16-63238 të Njesisë së Personelit të Komunës së Gjilanit bazuar në kërkesën e potencuar më lartë të Kryetarit të Komunës ankuesi është transferuar në këtë drejtori nga data 06.06.2022 deri më datën 05.11.2022.

Nga shkresat e lëndës dhe bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit kolegji i këshillit shqyrton pretendimin ankimor të ankuesit i cili deklaron se me datë 08.11.2022 për shkak se i ka kaluar afati i transferimit të përkohshëm në DZHE(Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik) është lajmëruar në punë sipas pozitës që mbanë përkatësisht në pozitën e Udhëheqësit të sektorit për inspektime/Drejtoria për Inspektime sipas aktemërimit aktual të datës 01.07.2020,për shkak që kishte skaduar afati i vendimit të transferimit të përkohshëm sipas vendimit të datës 03.06.2022 me nr.02-16-63238 të Njesisë së Personelit të Komunës së Gjilanit, por se drejtoresha nuk kishte qenë në punë at ditë pasi edhe ashtu zyra ku duhet të punojë ankuesi ka qenë e mbyllur dhe i njëjti ishte rikthyer në DZHE për të bërë dorëzimin e detyrës që kishte mbajtur deri në at datë, ndërsa ankuesi poashtu me datë 09.11.2022 në ora 7 e 50 minuta është lajmëruar dhe nënshkruar në librin e evidencës së punëtorëve të Drejtorisë së Inspektionit dhe se ankuesi e ka telefonuar drejtoreshën/ eproren e tij por se e njëjta nuk është lajmëruar në telefon. Në ndërkohë z. S.K. ka shkuar në kafiteri bashkë me 2 kolegë duke menduar se ndërkohë do të kthehet drejtoresha dhe do ti dorëzoj çelësat e zyrës dhe do të bëjë pranimin e detyrës.

Ndërsa Drejtoresha e Drejtorisë të Inspektionit më datë 09.11.2022 ka bërë kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore . dhe një zyrtari tjetër ndërsa ndaj 2 tjerëve jo edhe pse e njëjta është udhëheqëse e këtij institucioni dhe ka kompetencë për inicim të veprimeve administrative disiplinore konformë Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në këtë mënyrë përmes kësaj forme të inicimit të pjesshëm të procedurës disiplinore përkatësisht ndaj vetëm dy zyrtarëve të caktuar, e që përmes organeve të ndryshme të punësimit ju janë shqiptuar masa të ndryshme për veprime të njëjta, dhe poashtu duke mos ndërmarrë veprime disiplinore edhe ndaj dy zyrtarëve tjerë të drejtorisë përkatëse, përkundër që e njëjta përmes ankesës së datës 12.12.2022 drejtuar komisionit disiplinor kishte konfirmuar se kishte parë zyrtarët duke lëshuar vendin e punës përkatësisht duke shkuar në lokalë, por se e njëjta nuk ka arsyetuar faktin se mbi çfarë baze ligjore i ka

përrjashtuar zyrtarët tjerë nga ndërmarrja e veprimeve të ngjashme disiplinore ashtu si ka ndërmarrë ndaj ankuesit, andaj duke marrë për bazë këto fakte kolegji i këshillit konstaton se veprimet e eprores së ankuesit në këtë rast bien ndeshë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 7 paragrafi 1, ku shprehimisht parashihet: *"1 Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"* ndërsa ky veprim poashtu bie ndeshë edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi nga se në nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 parashihet *"1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji"*, ndërsa këto elemente do të duhej të i marrë parasysh komisioni disiplinor me rastin e trajtimit të këtij rasti dhe fakti që nuk ka marrë për bazë këtë rrethanë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e potencuara më lartë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesën e ankuesit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit, përmes vendimit të tij nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave mbi bazë të cilave është vendosur për masën e shqiptuar e mbi këtë bazë edhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale në këtë rast. Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi i datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore është bazuar në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 i Ligjit NR. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se *"3.5. braktisja e punës ose nuungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë"* ndërsa në këtë rast kolegji i këshillit konstaton se zyrtari në fjalë në këtë rast ankuesi nuk mund të konstatohet se i njëjti ka braktisur vendin e punës nga se nga administrimi i shkresave të lëndës nuk kemi ndonjë provë konkrete nga organi i punësimit se i njëjti të ketë bërë shkeljen e detyrave të punës mbi të cilën i është shqiptuar kjo masë disiplinore, për faktin se ankuesi kishte deklaruar edhe në seancë të komisionit disiplinor se i njëjti është lajmëruar në punë më datë 08.11.2022 dhe në mungesë të prezencës së drejtoreshës në zyre dhe me qenë se zyra e tij ishte e mbyllur i njëjti kishte shkuar në DZHE për të bërë dorëzimin e detyrës, poashtu më datë 09.11.2022 ankuesi ishte paraqitë në punë dhe që me këtë datë ishte nënshkruar në ora 7 e 50 në evidencën e punëtorëve të kësaj drejtorie dhe se i njëjti nuk ka mundur të hy në zyrën e tij nga se ka qenë e mbyllur, dhe se nga provat që ka ofruar komuna e Gjilanit nuk është ofruar ndonjë provë që argumenton të kundërtën e faktit që ankuesi më datë 09.11.2022 ishte nënshkruar në evidencën zyrtare të punëtorëve të Drejtorisë së Inspektionit, përkundrazi inicuesja e procedurës disiplinore në ankesën së datës 12.12.2022 në lidhje me përmbajtjen e vendimit të komisionit disiplinor, kishte deklaruar se *"personalisht i kamë parë kur kanë kaluar rrugën duke lëshuar vendin e punës pasi*

janë nënshkruar në listën për evidentimin e punëtorëve' 'që nënkupton dhe konfirmon faktin se i njëjti ka qenë në punë në këtë datë, andaj në këtë kuptim kolegji i këshillit konstaton se pretendimi i ankuesit është i bazuar rrjedhimisht argumentohet fakti se baza ligjore mbi të cilën është bazuar vendimi i komisionit disiplinor përveç që është i paargumentuar me prova relevante, paarsyetuar në mënyrë të duhur, kontradiktor sa i përket bazës ligjore në të cilën është thirr me rastin e nxjerrjes së të njëjtit për faktin se i referohet dispozitës së nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.5 e cila dispozitë parasheh: "3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë" dhe që konsiderohet shkelje e rëndë përderisa në përmbajtje të të njëjtit vendim konstatohet fakti se shqiptimi i masës disiplinore i shqiptohet për arsye ankuesi më datë 09.11.2022 në ora 8.16 ka braktisur vendin e punës, që sipas kolegjit të këshillit nënkuptohet se i njëjti ka qenë në vend të punës deri në këtë orë dhe poashtu nëse marrim për bazë deklaratën e ankuesit dhënë përmes shkresave të kësaj lënde vërtetohet fakti se i njëjti-ankuesi ishte kthyer në punë këtë ditë dhe kjo rrethanë nuk është kontestuar me asnjë veprim administrativë të organit të punësimit dhe poashtu edhe të komisionit disiplinor, duke përfshi edhe përmbajtjen e përgjigjes në ankesë të organit të punësimit dhe në këtë kuptim është e paqartë se si ka mundësi të trajtohet si shkelje e rëndë kjo situatë kur nuk kemi elemente që konsumojnë kryerjen e veprimit të paligjshëm bazuar në dispozitat e lartshënuara, ndërsa përkundër që komisioni disiplinor nuk ka mundur të argumentoj mungesën plotë e nga puna më datë 09.11.2022, përkatësisht një ditë të plotë dhe nëse marrim për bazë dispozitën e nenit 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1. Shkelje të lehta konsiderohen: "4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune", dhe përderisa nuk është provuar me fakte nga komisioni disiplinor se ankuesi ka munguar nga puna deri në 2 ditë, është e pakuptueshme për kolegjin se si ka mundësi të trajtohet veprimi i ankuesit si shkelje e rëndë, andaj kolegji i këshillit konstaton se përmbajtja e vendimit të komisionit disiplinor është i paqartë, jo i argumentuar, kundërthënës dhe i pakuptueshëm dhe nëse i referohemi Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 48 paragrafi 2 ku parashihet "2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", andaj në këtë kuptim Vendimi i datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit nuk mund të prodhojë ndonjë efektë juridik mbi arsyet e potencuara më lartë.

Siç u potencue më lartë Kolegji i këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde dhe me rastin e vendimmarrjes për këtë ankesë ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenit 45 paragrafi 1, nënparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 në të cilat dispozita parashihet "1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", andaj referuar në këto dispozita ,nëse marrim për bazë provat që gjenden në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në këtë procedurë dhe përmbajtjen vendimit të atakuar të komisionit disiplinor përmes kësaj ankese, kolegji i këshillit konstaton se nuk janë konsumuar elementet e një veprimi që cenon dispozitat që u potencuan më lartë nga ana e ankuesit nga se me asnjë provë relevante komisioni disiplinor nuk ka arrit të

argumentoj faktin e ekzistimit të veprimit të paligjshëm, fajësisë, pasojës së shkaktuar, dëmi që është shkaktuar si dhe ndërlidhjes së veprimeve të ankuesit me qëllim të konsumimit të veprimeve të paligjshme ashtu siç parashihet në dispozitat e lartshënuara dhe që janë vendimtare për tu vërtetuar fajësia në këtë proces disiplinor, dhe në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i bazuar nga se nuk është vërtetuar dhe argumentuar nga komisioni disiplinorë se ankuesi me veprimet e tija ka cenuar dispozitat e potencuara si më lartë.

Nga ajo që u deklarue më lartë dhe mbi bazën e shkresave të lëndës mund të konstatohet se Komisioni disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore respektivisht nga përmbajtja e vendimit të atakuar nuk ka marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që kanë të bëjnë me parimet e individualizimit të masave disiplinore përkatësisht nenin 50 paragrafi 1 nënparagrafi 1,1,1.2,1.3 dhe 1.4 ,nga se këto dispozita parashohin: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmi" andaj në këtë kuptim bazuar në vendimin e atakuar nga ankuesi, provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë këto dispozita të potencuara më lartë, pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar dhe argumenton faktin se ka veprime që shfaqin elementin e diskriminimit në raport me ankuesin, dhe të cilat dispozita u potencuan më lartë sa i përket këtij elementi.

Kolegji i këshillit nga shtjellimi i provave konstaton se me faktin se ankuesi nuk është ftuar paraprakisht nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë përkatësisht drejtoresha e Inspektionit për të diskutuar për shkeljen eventuale të detyrave të punës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik në të cilën dispozitë parashihet "6. Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj.....", andaj nga dispozitat e përshkruara si më lartë konfirmohet fakti se ankuesi nuk është informuar paraprakisht nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë për fillim të procedurës administrative disiplinore me qëllimin që të i jepet mundësia e diskutimit në lidhje me shkeljen eventuale të detyrave të punës dhe paraqitjen e fakteve që mund të jenë vendimtare në procesin disiplinorë që do të zhvillohej ndaj të njëjtit dhe që do të mund të ndërlidhej me rastin konkretë, në këtë formë shfaqë elementin e tendencës për të diskriminuar dhe diskredituar të njëjtin në këtë rast ankuesin duke shkelë në këtë rast edhe parimin e transparencës sa i përket menaxhimit të marrëdhënies së punës me zyrtarin publik siç parashihet në nenin 7 paragrafi 3 të Ligjit të Zyrtarëve Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka konstatuar se në provat e lëndës të ofruar nga organi i punësimit dhe të cilit i referohet në përgjigje në ankesë i njëjti organ, kemi një vendim Nr.02-56 të datës 28.01.2022 për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit

ndaj ankuesit , poshtu kemi edhe një vendim me përmbajtje të njëjtë të shqiptimit të një mase disiplinore në lidhje me rastin e njëjtë që ndërlidhet me objektin e kësaj ankese ndaj zyrtarit A.K, përkundër që ndaj të njëjtëve nuk ka pasur ankesë, Kolegji i këshillit sa i përket kësaj çështje ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbimin Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për inicimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ” dhe në këtë kuptim vendimi Nr.02-56 të datës 28.01.2022 për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje” e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit ndaj ankuesit nuk mund të ketë ndonjë relevancë juridike nga arsyet ligjore të specifikuar më lartë dhe që mund të ndërlidhet me vendimin e komisionit disiplinor të kontestuar sipas kësaj ankese.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të ankesës së ankuesit dhe provave që i ka sjellë organi i punësimit, ka trajtuar edhe një foto të dërguar nga organi i njëjtë dhe ka konstatuar se fotografia e ofruar nga organi i punësimit përkatësisht nga Drejtoresha e Drejtorisë së Inspekcionit ndërsa sipas deklarimit të ankuesit në kafiteri përveç ankuesit bashkë në tavolinë kanë qenë edhe katër persona tjerë e që sipas ankuesit janë 2 zyrtarë të drejtorisë përkatëse që kishin qenë në tavolinë me të dhe at zyrtari A.K dhe R.A,si dhe dy shokë tjerë, dhe poashtu në të njëjtin lokal vetëm se në tavolinë tjetër ka qenë edhe një zyrtarë tjetër i të njëjtës drejtori dhe atë zyrtari V.I, përveç që nuk mund të identifikohet qartë ankuesi, poashtu nga elementet që përmban fotoja nuk mund të konfirmohet saktë nga kush është bërë për faktin se edhe drejtoresha në këtë rast në cilësinë e mbikëqyrëses përkatësisht inicueses së procedurës disiplinore përmes ankesës së datës 12.12.2022 në lidhje me përmbajtjen e vendimit të komisionit disiplinor, kishte deklaruar se:” *personalisht i kamë parë kur kanë kaluar rrugën duke lëshuar vendin e punës pasi janë nënshkruar në listën për evidentimin e punëtorëve* ’ por se nuk ka konfirmuar faktin se e njëjta i ka fotografuar në lokal andaj në këtë situatë bëhet fjalë për një foto mbi bazën e së cilës i është shqiptuar masa disiplinore ankuesit, pa ditë autorësinë e kësaj foto ,andaj për kolegjin e këshillit duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi ku fotografimi i paautorizuar nga organet kompetente bie ndeshë me legjislacionin në fuqi, nga se është vepër penale e sanksionuar me kodin penal të Republikës së Kosovës, ndërsa në këtë kuptim një provë e marrë në kundërshtim me ligjet në fuqi nuk mund të prodhojë ndonjë efekt juridik dhe nuk do të duhej të merrej për bazë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore që i është shqiptuar ankuesit nga komisioni disiplinor mbi bazën e vetëm kësaj prove.

Kolegji i këshillit bazuar në shkresat e lëndës me rastin e vendimmarrjes sa i përket kësaj ankese pati parasysh edhe rrethanën se inicuesja e procedurës disiplinore nuk kishte marrë pjesë në seancën e komisionit disiplinorë përkundër që ishte ftuar me rregull dhe rrjedhimisht disa gjëra kishin mbetur pa u sqaruar dhe definuar në mënyrën më të mirë dhe që për kolegjin e këshillit do të ishin me rëndësi vendimtare, poashtu është marrë për bazë edhe fakti se përmes provës përkatësisht formularit të vlerësimit të vitit paraparak-2021, ankuesi ishte vlerësuar me notë maksimale respektivisht me notën 5.00, poashtu ka marrë për bazë edhe çështjen e transferimit të përkohshëm sipas vendimit që gjendet në shkresat e lëndës, nga se organi i punësimit transferin e përkohshëm e ka bërë mbi bazën e interesit të institucionit që nënkuptohet se ankuesi me sukses i ka ushtruar detyrat që i ka pas të caktuar sipas përshkrimit të detyrave të punës sipas pozitës së përhershme që e mbanë bazuar në aktemrimin e tij që është në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazën e asaj që u potencue më lartë konstaton se Vendimi i datës 08.12.2022 me Nr.02/016/01-0140-533/22 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë , Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe si i tillë ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkaqet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës ,bazuar në arsyetimin e sipërm dhe si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.17/2023, datë 20/02/2023

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të Autorizuar të ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.